



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1044/ Prot.

VENDIM

Tiranë, më 04.05.2021

Nr. 124, datë 27.04.2021

**PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE PËR  
POZICIONIN VAKANT NR. 3 NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË  
APELIT TIRANË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 332, DATË 29.12.2020 TË  
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 66 të Ligjit nr. 44/2015 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenin 44 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Pezullimin e procedurës në lidhje me lëvizjen paralele për pozicionin vakant nr. 3, shpallur me Vendimin nr.332, datë 29.12.2020 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të ankimit në gjykatë.
2. Të njoftohen për këtë vendim kandidatët e listuar në renditjen e Vendimit të Këshillit Nr. 95 datë 31.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR  
MOISI DUDA**

**ANËTAR  
VATË STAKA**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**